

Data 25.05.2023.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“ Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Kokreve faza e I-re ,Njesia Administrative Hotolisht ,Bashkia Librazhd”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV : Punime shtrimi dhe asfaltimi: 45233222-1 .

Fondi limit: 83 237 019 (tetedhete e tre milion e dyqind e tridhete e shtate mije e nentembedhete) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertes + preventivin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Nuk aplikohet ne kete rast.**

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiroja mesatare vjetore per nje periudhe maksimumi deri ne 3(tre) vitet e fundit financiare , duhet të ketë një vlerë te pakten sa vlera e parashikuar te kontrates(jo me e vogel se vlera e fondit limit) , pa perfshire vleren e TVSH-se, per te cilin duhet te paraqitet vertetim leshuar nga administrata tatimore. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nqs Operatoret Ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale , ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga AK si me lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve të fundit (2019 – 2020-2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar , neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i

ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2021 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2022.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2021 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim : Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar.

3.Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e fondit limit të lotit për të cilin konkuron dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i fondit limit të lotit për të cilin konkuron.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikatën e marrjes në dorëzim të perkohshëm/përfundimtar.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore;
 - Akt kolaudimi objekti.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.1, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatorën e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 42, , në rastin e procedurave të hapura, në nenin 47, dhe 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme në një objekt të vetëm të jenë minimalisht në vlerat 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar, ose për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur në rendesine e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të venë në dispozicion , tipologjinë e punimeve të ndërtimit si edhe mbështetur në LPP dhe në RRPP.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe

disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Punime të Përgjithshme Ndërtimi

- NP.1 B Punime gjurmimi në tokë
- NP.4 B Rruge autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP.5 B Punime Nentoksore, ura e vepra arti
- NP.12 A Punime te inxhinierise se mjedisit

Punime Speciale Ndërtimi:

- N.S-6 A Sinjalistike rrugore jo ndricuese
- N.S 18 A Punime topogjeodezike
- Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", pikat e licences dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbeshtetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vleren totale te punimeve per secilen kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NS-1	Punime per prishjen e ndertimeve .	Percaktimet ne preventiv	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
NP 4	Rruge ,autostrada etj.	Percaktimet ne preventiv	B	E kalon vleren 20 milion leke.

NP 1	Punime germimi ne toke	Percaktimet preventiv ne	B	E kalon vleren 20 milion leke.
NS 6	Sinjalistike rrugore ndricuese jo	Percaktimet preventiv ne	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
NS 18	Punime topogjeodezike	Percaktimet preventiv ne	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
NP 5	Punime Nentoksore, ura e vepra arti	Percaktimet preventive ne	B	E kalon vleren 20 milion leke
NP 12	Punime se inxhinierise se mjedisit	Percaktimet preventive ne	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoare **minimalisht 80 (tetëdhjetë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve per nje periudhe 3 mujore nga data e zhvillimit te tenderit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8. Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet te dorezoje dokumentacionin si me poshte :

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj .
- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorinë dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shogeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , Kodi i Punes ne RSH , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit. Komisioni i perllogaritjes se vleres se fondit limit dhe pergatitjes se dosjes teknike kane analizuar dhe perllogarithur numrin minimal te punetorese prej 80 punonjesish mesatarisht te dosmosdoshem per realizimin e objektit te prokurimit ne nje afat kohor 6 muaj - grafik punimesh.

2.3.3. Referuar preventivit, grafikut, specifikimeve teknike si dhe punimeve ndertimore, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

Për secilin nga drejtuesit teknike si me sipër te paraqitet :

- a) Kontrate pune;
- b) Diplome ;
- c) Libreze pune;
- d) CV

-Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

-Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

- a. Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij min. 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë pajisur me çertifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi”, të vërtetuar me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit, kontratë pune të vlefshme, diplomë, i cili të figurojë në listpagesat e shoqërisë të paktën 3 muajt e fundit.
- b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë çertifikatë e trajnimit si "Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"

në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier", si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 3 muajt e fundit .

- c. Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”,e cila te jete e leshuar nga shoqeri të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, te cilet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë të paktën 3 muajt e fundit.
- d. Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre min. 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjes e mjedisit”, i ndryshuar. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) **Kontrate pune;**
- b) **diplome/certificate**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e

kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”. Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipozitive ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të kete te punesuar, punonjës të kualifikuar, të pajisur me dëshmi profesionale sipas profesioneve si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi Profili Transport

3 (tre) Teknik Ndertimi

1 (nje) Teknik Topograf

4 (kater) Karpeniere

3 (tre) Hekurkthyes

3 (tre) Pllakashtrues/Hidroizolues

1 (nje) Mekanik

2 (dy) Hidraulik

2 (dy) Murator

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

-Kontratë punë te vlefshme.

-Diplome/deshmi profesionale përkatëse

-Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit .

-Per tekniket e ndertmit dhe per teknikun topograf do te pranohen vetem diplomat e shkollës se mesme profesionale ose licensat perkatese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shogeruese te

ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 3.5, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar te pakten **6 (gjashte) Manovratorë**, nga te cilet 2 automakiniste dhe 4 eskavatoriste. Per manovratorët e mjeteve te renda, te paraqitet kontrate pune, deshmi e drejtimit nga DPSHTRR, te cilat duhet te jene te vlefshme si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar te pakten **5 (pese) Shofere**, te paraqitet kontrate pune, deshmi e drejtimit nga DPSHTRR, te cilat duhet te jene te vlefshme si dhe dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve) si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikat a, b, d, dh, e, h, I, j të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një listë personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafin teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohej e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 3.6, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve. Detyrimisht të paraqitet kontrata noteriale si dhe dokumenti i akreditimit.

2.3.12 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
--------	-------	---------

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	3 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës 10-12 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine kapaciteti mbajtës minimum 3.5-5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1-3 ton	3 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	4 cope	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	2 cope	Pronësi ose me qera
Ekskavator me goma	4 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire me peshe 9 Ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Ekskavator me zinxhire	1 cope	Pronësi ose me qera
Grejder me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator me peshe 3-5 Ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-gome me kapacitet 10-13 Ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-gome me kapacitet 18 Ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul asfalti me gomë – gomë kapaciteti 5 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Kompaktor	2 cope	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	4 copë	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Makineri prerese asfalti (sharre)	1 cope	Pronësi ose me qera
Makineri Vijezi	1 cope	Pronësi ose me qera

Pajsje gjeodezike tip Nivelues me aksesore perkates	1 cope	Pronësi ose me qera
Pajsje gjeodezike tip Total station me aksesor perkates	1 cope	Pronësi ose me qera
Fabrike asfaltobetoni e pajisur me leje mjedisore III.1.B	1 cope	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Nyje prodhim inertesh e pajisur me leje mjedisore III.1.B	1 cope	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Fabrike e prodhimit te elementeve te betonit - bordurave dhe pllakave	1 cope	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Fabrike Betoni	1 cope	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Dumper kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	4 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	3 copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	2 copë	Pronësi ose me qera
Kulle ndriçimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator mbi 50kva	1 copë	Pronësi ose me qera
Badipald per sinjalistike	1 copë	Pronësi ose me qera
Buldozer	1 copë	Pronësi ose me qera

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar**. Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit:

- certifikaten e pronësisë;
- lejen e qarkullimit;

- certifikaten e kontrollit teknik;
- siguracionin;
- certifikate transporti lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe fotot perkatese; ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatese fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, nuk janë të angazhuara në procedurat e shpallura fitues nga autoriteti kontraktor dhe do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrata. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.13 Operatorët ekonomikë, duhet të kenë 1 (një) gurore për veprimtari minerale për shfrytëzimin e llojit mineral gëqerorë, pllakor që bën pjesë në llojin e mineraleve ndërtimore, e cila duhet të jetë e pajisur me dokument pronësie dhe leje IV.1.B.2, shoqëruar me akt miratimit të lejeve lëshuar nga autoritetet e autorizuar me ligj. Në rastin kur, operatorët ekonomikë kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makineritë të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre “(përlllogaritja e oreve të punës si edhe të mjeteve të nevojshme) , bazuar në tipologjinë e zerave të preventivit , analizave perkatese të zerave të preventivit etj, nga specialistet perkates të inxhinierë, nga grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta teknike të kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë

në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

2.3.14 Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar ne SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi.

- Tombino betoni

2.3.15 Operatorët ekonomik duhet të kenë Fabrike e prodhimit te elementeve te betonit - bordurave dhe pllakave duhet te jete e pajisur me skemen teknologjike te makinerise, planvendosje, leje mjedisore nga QKL. Fabrike e prodhimit te elementeve te betonit - bordurave dhe pllakave.

- a) Per Fabriken e Asfalto-Betonit dhe Linjen e Prodhimit te Materialeve Inerte duhet te paraqiten dokumentet e pronesisë si akte çdoganimi ose fatura tatimore te blerjes, leja mjedisore e leshuar nga QKL kodi III.1.B + Akt-Miratimin, si dhe Planvendosje e vendodhjes se objektit e cila ne rastin e fabrikes se Asfalto-Betonit nuk duhet te jete ne distance me te madhe se 35 km nga objekti i prokurimit. Ne rastin e fabrikes/linjes me qera/kontrate furnizimi dokumentete e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Operatori ekonomik duhet te deklaroje vendodhjen e sakte te impiantit, te paraqese planin e vendosjes dhe fotografi te impiantit (referuar percaktimeve te VKM 628 DT 15.07.2015). Perjashtohen rastet kur Impianti eshte mobile (i levizshem). Ne kete rast operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin ligjor qe vereteton pronesine e tij (fature tatimore/zhdoganimi ose kontrate shitblerjeje si dhe e shoqeruar me foto).

2.3.16 Per Impiantin e prodhimit te asfaltobetonit duhet te paraqese Raport Vetemonitorimi planvendosjen dhe projektin teknologjik.

2.3.17 Per fabriken e Betonit operatori ekonomik duhet te paraqese Certificate Inspektimi/Kalibrimi.

2.3.18 Analizat e cmimeve per cdo ze te preventivit mosparaqitja e tyre perben shkak per skualifikim.

3.10.Cdo ofertues duhet te paraqese grafikun e punimeve te firmosur dhe vulosur nga administratori. Ne rast BO grafikun e punimeve duhet te jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme, etj. bazuar ne tipologjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhinierë, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te vecanta teknike te kualifikimit .

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe menaxhimit të energjisë. Për këtë duhet të paraqesë çertifikatat e mëposhtme:

- a) ISO 9001: 2015 mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*” e vlefshme, ose ekuivalente
- b) OHSAS 18001:2007 mbi “*Shëndetin dhe sigurimin në punë*” e vlefshme, ose ISO 45001:2018 ose ekuivalente
- c) ISO 14001:2015 mbi “*Sistemet e menaxhimit të ambientit*” e vlefshme, ose ekuivalente
- d) ISO 39001:2012 mbi “*Sistemet e menaxhimit të sigurisë*” e vlefshme, ose ekuivalente

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe gjatë periudhës së parashikuar për zbatimin e kontratës .**Te gjitha çertifikata e mesiperme duhet te jene te të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

Çertifikatat e mësipëme kërkohen të jenë të vlefshme.

Ne zbatim të nenit 44 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 autoriteti pranon çdo certifikatë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me liçensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B”, së bashku me aktin e miratimit.

2.3.8 Operatorët Ekonomik të ketë liçensë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, e lëshuar nga QKL, Kodi III.2.A. (1+2).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , bazuar ne tipollogjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhinierie, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te vecanta teknike te kualifikimit .

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: : (Operatori ekonomik duhet të disponojë leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B). Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet perkatese të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për

raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve teknike dhe relacionit bashkangjitur DST.